

ORGANIZATA "TË NDRYSHËM DHE TË BARABARTË" ORGANIZOI NJË SËRË VEPRIMTARISH NDËRGJEGJËSUESE DHE INFORMUESE MBI TRAFIKIMIN E PERSONAVE

Organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë” gjatë muajit tetor i njohur edhe si muaji i ndërgjegjësimit ndaj trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri, nëpërmjet Njësive Lëvizëse në Tiranë dhe në Shkodër në bashkëpunim me institucionet shtetërore e ka fokusuar veprimtarinë ndërgjegjësuese në disa kategori shoqërore si në komunitet, në komisariate, në shkolla 9-vjeçare dhe të mesme.

Tetori është muaji i ndërgjegjësimit për trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri.

Si pjesë e aktiviteteve të realizuara në 21 shkolla të rrethit të Tiranës dhe Shkodrës janë informuar rreth 400 nxënës me të cilët ndërgjegjësimi mbi fenomenin është shoqëruar me shembuj praktik, me aktivitete nëpërmjet lojës, punimeve artistike, ekspozitave, forumeve, sesioneve informuese me theksin tek treguesit e rrezikut për t’u trafikuar dhe adresimin e dyshimit apo shqetësimit për çdo rast.



Gjatë zhvillimit të aktiviteteve në shkolla ka patur interesim të lartë nga nxënësit për t’u informuar mbi këto çështje veçanërisht për rastet kur trafikanti mund të jetë një i afërm ose një pjesëtar i familjes.

**“Ne duhet të bëjmë shumë kujdes për veten por edhe për të tjerët që kemi afër. Nuk duhet të jemi indiferent!”
-thotë A.J., nxënëse, në shkollën “Aleksander Paloci” Shelqet, Shkodër.**



Takime të shumta informuese me qëllim fuqizimin e kapaciteteve të punonjësve janë realizuar në katër komisariate si ai i Kavajës, Rogozhinës, Vorës dhe Kamzës ku 24 inspektorë të policimit në komunitet, jo vetëm që kanë vendosur kontakte me Njësinë Lëvizëse por dhe kanë diskutuar sfidat në kuadër të identifikimit, referimit dhe riintegritimit të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit.

**“Është shumë e rëndësishme dhënia e informacionit të duhur për identifikimin dhe referimin e viktimave”
thotë inspektori i Policimit në Komunitet në qytetin e Kavajës.**

Gjithashtu pjesë e takimeve për fuqizimin e kapaciteteve kanë qënë edhe punonjës të Njësive Administrative si dhe stafi i shkollave.